# UDHËTIM NË VIETNAM : NGA HANOI NË HO CHI MINH

## Dita 1 : Nisja nga Tirana

Nisja nga Tirana ne oren 14.00

## Dita 2 : Hanoi

Mbërritja në aeroportin ndërkombëtar Noi Bai ne oren 12.40.

Pas marrjes së vizës dhe bagazheve  do te takohemi me partnered tane per tu transferuar ne hotel.

Marrja e dhomave dhe kohe e lire per tu clodhur.

Pasdite do te vizitojme qytetin e Hanoit.

12:00: Transferta per ne restorant per dreken.

13:30: Pas drekes do te fillojme vizitën e qytetit të Hanoi. Ndalesa e pare eshte Pagoda Tran Quoc në Ishullin e Peshkut të Artë në Liqenin Perëndimor, e cila është pagoda më e vjetër në Ha Noi, ndërtuar në shekullin e 6-të.

15:00: do te vazhdojme viziten ne Tempullin e Letërsisë – Universiteti i parë i Vietnamit, themeluar në shekullin e 11-të.

16:00: Vizite ne Liqenin Hoan Kiem ku do te shijojme nja nga shfaqjet me tradicionale Vietnameze per 45 minuta.. **Shfaqje me Kukulla Uji** - një art unik i veriut të Vietnamit, që përshkruan skena nga jeta rurale dhe episode nga historia kombëtare.

Kthim ne hotel dhe mbremje e lire.

## Dita 3 : Hoa Lu - Tam Coc

08:00: Nisja nga hoteli per ne Hoa Lu pasi te keni konsumuar mengjesin

09:15: Pushim i shkurtër për 15 – 20 minuta për relaksim.

10:30: Vizite ne kryeqytetin e lashtë Hoa Lu të Vietnamit nga viti 968 deri në 1010 ku do te njiheni me historinë vietnameze në sistemin feudal nën dinastitë Dinh, Le dhe Ly.

11:45: Drekë ne restorant vendas

13:30: Vizitë në Tam Coc ku me barka bambuje do te beni nje shetitje per rreth 1.5 orë pergjate lumit  dhe do të befasoheni nga bukuria e mahnitshme e fushave te orizit, lumit

dhe një sistemi shpellash . Të gjitha krijojnë një kryevepër që vietnamezët e quajnë "Ha Long Bay në tokë".

16:00: Kthimi në Hanoi.

18:00: Kthim ne hotel dhe mbremje e lire.

## Dita e 4 : Ha Noi – Ha Long Bay – Nje Nate Ne Krocere

07:45 - 08:30: Nisja nga hoteli drejt Ha Long Bay. Ne nje udhetim te kendshem do te shijoni peizazhin e mrekullueshem te Deltës së Lumit të Kuq.

11:30: Mberritja ne stacionin e krocerave Tuan Chau Marina, ku mund te shlodheni dhe qetesoheni nderkohe qe stafi merret me regjistrimin ne krocere.

12:00 - 12:30: Kapiteni i lundrimit dhe stafi do t'ju mirëpresin në bord në LE JOURNEY CRUISE pas një transferimi të shkurtër me anije. Ndërsa shijoni një pije mirëseardhjeje freskuese, do të njiheni me programin e lundrimit dhe udhëzimet e sigurise.

12:30 - 13:00: LE JOURNEY CRUISE fillon lundrimin drejt Ha Long Bay – një nga Shtatë Mrekullitë e Reja të Natyrës në Botë. Dreka shërbehet në bord ndërsa lundrimi kalon formacionet e mrekullueshme të karstit gëlqeror që ngrihen nga deti në një mënyrë mbresëlënëse.

14:00 - 14:30: Nje ndalese do te behet për të eksploruar Shpellën Sung Sot (e njohur gjithashtu si Shpella e Befasisë/ Mrekullisë), një nga shpellat më të mëdha dhe më të bukura në Ha Long Bay.

15:00: Kthimi në LE JOURNEY CRUISE, udhëtimi do të vazhdojë drejt Ishullit Ti Top. Këtu, mund të shikoni pamjen madhështore mbi Gjirin e Tonkin ose të notoni në ujin e gjelbër të smeraldte dhe të freskët.

17:00: Pas një dite të gjatë, kjo është koha ideale për 'Happy Hour', per të shijuar pije energjike dhe snacks.

19:30: Darka e pasur shërbehet ne bord ku do te shijoni ushqimet lokale të shijshme të përgatitura dhe shërbyera për ju nga nje staf I mrekullueshem ne krocere.

20:30: Pas darkës, organizohen aktivitete të ndryshme përfshirë karaoke dhe peshkim i kallamarëve. Ose mund të relaksoheni me pije freskuese nga bari.

## Dita 5 : Ha Long Bay – Hanoi - Da Nang

06:15 - 07:00: Sherbehet mengjesi me pamjen e mrekullueshme të lindjes së diellit në Ha Long Bay.

08:00 - 09:30: Anija i afrohet qendrës së Parkut Natyror ku do te lini anijen per nje udhëtim të shkurtër në Shpellën Luon. Kjo vepër magjike e natyrës ju tregon formimin e maleve karstike. Mund ta zbuloni këtë kryevepër edhe individualisht me kajak nese deshironi. Nëse jeni me fat, mund të beni foto shume te bukura me majmunë duke kërcyer rreth shkëmbinjve.

09:30: Kthimi ne Bord ne LE JOURNEY Cruise

10:00: Nje drake e shijshme do te sherbehet ne bord gjate lundrimit te kthimit

11:35: Mberritja në Tuan Chau Marina ku do te lme anijen

Transferim i shpejtë në aeroport për fluturimin për në Da Nang.

Pas mbërritjes, transferta ne hotel në Da Nang për check-in.

## Dita 6 : Da Nang – Gjiri Son Tra – Mali I Mermerit – Hoi An

Mëngjes në hotel dhe kohe e lire per plazh, shetitje buze detit ose shopping suvenire.

15:00: Nisja për të vizituar gjirin Son Tra (Mali i Majmunëve) ku do te vizitojme pagodën Linh Ung dhestatujën e Zonjës Buddha…

Me pas do te vazhdojme në Malet e Mermerit. Vizite ne fshatin Non Nuoc në këmbët e Maleve të Mermerit. Fshati është i famshëm për skulpturat dhe artizanatet prej guri. Këtu mund të admironi shumë vepra arti të bëra nga gur dhe mermer nga artistët lokalë. Nëse dëshironi të sfidoni veten fizikisht mund te ngjiteni ne Malin e Ujit, një nga pesë malet në grup (me rreth 150 shkalle). Këtu mund të vizitoni shumë shpella natyrore si shpella Huyen Khong, shpella Tang Chon dhe shpella Hoa Nghiem. Përveç kësaj, ka edhe vende fetare, duke përfshirë pagodën e parë Linh Ung në Da Nang, pagodën Tam Thai dhe shumë pagoda të tjera të bukura. Pas vizites ne Malet e Mermerit dhe fshatin Non Nuoc, vazhdojme rrugen per në qytetin e lashtë Hoian.

Hoian, një nga vendet e Trashëgimisë Botërore ofron nje atmosphere te kendshme te cilen do ta shijojme duke shetitur rreth këtij qyteti, do të vizitojmë shtëpitë e lashta, sallën e asamblesë së lashtë, tempullin e paraardhësve dhe simbolin e Hoianit, Urën Pagoda Japoneze. Në Hoian, gjithçka është ruajtur siç ka qenë qindra vjet më parë.

21:00 Pas nje darke te lehte kthimi ne hotel ne Da Nang.

## Dita 7 : Kodrat Ba Na Dhe Ura E Artë

09.00 Pas mëngjesit në hotel, transferim për në kodrat Ba Na dhe marrje e teleferikut që arrin 5 rekorde botërore në stacionin e kodrave Ba Na. Ndalese në stacionin By Night për të vizituar kodrat Vong Nguyet, pagodën Linh Ung, Vilat e Vjetra Franceze, urën e artë…

Vazhdojme ngjitjen lart me teleferik në Malin Nui Chua – maja e vargut Ba Na, duke vizituar majën Nghinh Phong, Vilat Le Nim, Kopshtin e Orkideve... shijoni udhetimin me trenin e ngjitjes në kodër (funikulari i parë dhe unik në Vietnam) dhe vizitoni një qilar të vjetër Vere francez (Qilari i Verës së Lashtë Debay), kopshtin e luleve Le Jardin D'amour.

Drekë bufet vietnameze do të shërbehet në restorant.

Pas drekes kohe e lire per te eksploruar kodrat Ba Na në mënyrë të pavarur.

Rreth orës 15:00, do të kthehemi në teleferik dhe transferta per ne aeroport per te marre fluturimin ne Ho Chi Minh.

Mberritja ne Ho Chi Minh dhe akomodim ne hotel.

## Dita 8 : Tunneli Cu Chi & Delta E Mekongut – Dite E Plote

Pas mengjesit do te nisemi per te vizituar qytetin My Tho. Vizite Vinh Trang Pagoda, nje vend I shenjte, nje nga atraksionet me kryesore te ketij qyteti.

Me udhëtim me varkë në lumin Tien per te shijuar mrekullite natyrore te katër ishujve të bukur si Dragoi, Unikorn, Feniksi dhe Breshka përgjatë lumit.

Do te lundrojme përmes kanalit të vogël me sampan, duke shijuar bukurinë e fshatit dhe duke bërë një çiklizëm të shkurtër rreth tij, që do të jetë sigurisht një përvojë e paharrueshme.

Do te vizitojme punishten e karamelit të kokosit dhe do te shijojme fruta të shijshme sezonale dhe çaj me mjaltë duke shijuar muzikën popullore të Vietnamit Jugor e cila interpretohet nga njerëzit vendas.

Kthimi në Ho Chi Minh dhe mbremje e lire.

## Dita 9 : Nisja Nga Ho Chi Minh Me Kujtime Të Ëmbla

Kjo eshte dita e fundit e programit tone të pushimeve!

Pas një mëngjesi të shijshëm në hotel do te bëhemi gati për të lënë hotelin dhe te nisemi per te vizituar Tunelet Cu Chi, nje udhetim qe zgjat rreth një orë e gjysmë me autobus. Para se të eksplorojme tunelet, do të shikojme një video prezantuese për mënyrën se si janë ndertuar tunelet dhe si vietnamezët mbijetuan në kushte të vështira gjatë luftës. Me pas do te ekspolorojme sistemin e tuneleve që përfshijnë zona të veçanta të jetesës me kuzhina dhe dhoma gjumi ngjitur me objekte të tjera ushtarake si fabrika armësh, spitale fushore dhe qendra komanduese që ndihmonin ata që jetonin brenda tunelit të plotësonin nevojat e tyre themelore. Përveç kësaj, ka gjithashtu shumë dyer të fshehta dhe kurthe të rrezikshme brenda tuneleve të ngjashme me labirint për qëllime sigurie gjatë luftës. Pas

kësaj, çaji special dhe kasava (ushqimi i guerilëve gjatë luftës) do të shërbehet. Koha për pushim.

Pas perfundimit te ketij turi do te nisemi drejt aeroportit me kujtime të paharrueshme. Transferta ne aeroport per te marre fluturimin e kthimit.

Nisja e avionit 18.25. Mberritja ne Tirane ne 13.05 (**dt 23 Mars**)

*Shënim: Duhet të visheni modestisht duke mbuluar supet dhe gjunjët gjate vizitave ne tempuj dhe pagoda.*

## Fluturimi

**Fluturimi Shqiperi – Vietnam 02 Maj 2025**
Nisja nga Tirana Airport (TIA) 12:50 – 20:10 Dubai International Airport (DXB)
Dubai International Airport (DXB) 03:30 – 13:15 Noi Bai International Airport (HAN)

**Fluturimi Vietnam – Shqiperi 10 Maj 2025**
Nisja nga Noi Bai International Airport (HAN) 23:50 – 04:05 Dubai International Airport (DXB)
Dubai International Airport (DXB) 08:10 – 11:50 Tirana Airport (TIA)

Elite Travel Agency

## Detajet e Turit

Ju lutem shikoni më poshtë të gjitha detajet e Turit

**Përfshihen në çmim :**

- Fluturimi vajtje/ardhje nga Tirana me tranzit
- Fluturimi Hanoi – Da Nang
- Fluturimi Da Nang – Ho Chi Minh
- Akomodimi sipas detajeve me poshte:
    - 2 Nete ne Hanoi: Golden Legend Boutique Hotel
    - 1 Nate Halong Bay : Le Journey Cruise
    - 2 Nete ne Da Nang : Santa Luxury Hotel 4*
    - 2 Nete Ho Chi Minh : Elios Hotel Sai Gon
- Lundrimi me krocere ne Ha Long Bay
- Transferta me autobuz komod gjate gjithe udhetimit
- Te gjitha aktivitetet dhe biletat e hyrjeve qe permenden ne program
- Mengjes + Dreke
- Shoqerues shqiptar nga agjensia
- Guide vendase ne anglisht

**Nuk përfshihen:**

- Viza Vietnameze (55 USD)
- Darka

## Shumë e rëndësishme :

**● Sugjerojmë që gjithë klientet të pajisen me siguracion shëndetësor për cdo udhëtim. Siguracionin mund ta bleni pranë agjencisë sonë ose te agjencia juaj e udhëtimit.**

⚫ **Pasaporta duhet të jetë e padëmtuar dhe brenda afatit të vlefshmërisë (6 muaj)**

# Politikat e Shërbimit

Rezervimi me Elite Travel Agency është i sigurt dhe i thjeshtë

**PA KOSTO TË FSHEHURA**
Shikoni çdo çmim të mundshëm pa tarifa rezervimi ose kosto të tjera të fshehura.

**SIGURI NË TRANSAKSIONET TUAJA**
Ne ndjekim standardet më të larta të protokolleve të sigurisë për t'i ofruar mysafirëve tanë siguri "online".

**POLITIKAT E PRIVATËSISË**
Ne interesohemi për privatësinë e të dhënave tuaja personale dhe marrim të gjitha masat për t'u siguruar që jemi duke ecur me hapin e kohës përsa i përket rregullave për mbrojtjen e të dhënave.

**SHËRBIMI NDAJ KLIENTIT**
Rezervimi në faqen tonë është i shpejtë dhe i thjeshtë. Nëse keni kërkesa specifike, ekipi ynë I Operacioneve do të jetë gati për t'ju asistuar.

**KONFIRMIMI I REZERVIMIT ME E-MAIL**
Menjëherë pasi të keni kryer rezervimin, një e-mail me të gjitha detajet e rezervimit do të vijë në adresën tuaj.

**PAGESA PER REZERVIMIN**
Pagesa per rezervimin do te kryhet ne dy pjese: 50% e pageses do te kryhet ne momentin e rezervimit, 50% deri ne 21 dite para nisjes
Nëse dëshironi të ndryshoni specifikat e rezervimit tuaj, mund të na kontaktoni në një nga numrat e telefonit ose me e-mail.

**POLITIKAT E KANCELIMEVE**
Ne rast te anullimit nga klienti aplikohen penalitetet si me poshte :
40 % nese anullimi behet deri 30 dite perpara nisjes
75 % nese anullimi behet 30 deri ne 15 dite perpara nisjes 100% nese anullimi behet 14 dite perpara nisjes

Elite Travel Agency

Nese klienti qe kerkon te anulloje udhetimin e zevendeson rezervimin e tij me nje person tjeter, atehere politikat e anullimeve do te diksutohen sipas rastit konkret.
Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet personalisht (ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit kur udhëtimi është rezervuar në grup) në njërën nga zyrat e agjencisë ose duke dërguar e-mail në adresën info@etg.al për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë.